

Primi i sigurimit Mtpl kategoria - Autoveturë dhe faktorëve të riskut që aplikohen nga shoqëria ANSIG sh.a.

- Shoqëria e sigurimit Ansig sh.a. në zbatim të Rregullores nr. 156, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, ka aplikuar faktorët e riskut në përlogaritjen e primit të sigurimit për kategorinë e autoveturave të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL e brendshme.
- Primi i sigurimit përlogaritur më sipër shpërndahet në nivel kategorie B1-Autoveturë në nënkategoritë përkatëse bazuar në klasifikimin e faktorëve të riskut.

$$P_{s,k} = \frac{Pr,k}{1 - (\alpha + \beta + \gamma)}$$

- Në vijim në bazë të rregullores aplikohen dhe faktorët e tjerë të riskut si më poshtë:

$$PS,FR = PS,K \cdot hD \cdot gj \cdot mi \cdot ne \cdot Ps,i \cdot Qp \cdot Vm \cdot Ftj$$

ku - PS,FR përfaqëson primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut;

ku

- hD përfaqëson faktorin e riskut Historiku i dëmeve për të siguruarin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit

- gj përfaqëson faktorin e riskut fuqia motorike;

- mi përfaqëson faktorin e riskut mosha e të siguruarit;

Për këtë faktor do të quhet 21 vjec, deri 21 vjec e 6 muaj dhe 22 vjec do te jete 21 vjec, 6 muaj e 1 ditë.

- ne përfaqëson faktorin e riskut eksperiencia në drejtim të mjetit motorik;

- $Ps, ,$ përfaqëson faktorin e riskut Përdorimi i mjetit: subjekt, individ;

- Qp , përfaqëson faktorin e riskut Qarkun e regjistrimit të mjetit;

- Vm , përfaqëson faktorin e riskut Vjetërsia e mjetit.

Shoqëria Ansig sh.a. bazuar në bazën teknike të dhënave të 5 viteve të fundit dhe rregullores nr. 156, datë 19.09.2024 përcakton faktorët e riskut si më poshtë:

- hD përfaqëson faktorin e riskut Historiku i dëmeve për të siguruarin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit-

Ky faktor risku për vitin 2025 do të jete 1, pasi viti 2025 konsiderohet viti 0.

- g_j përfaqëson faktorin e riskut fuqia motorike dhe indeksi j ndahet në shtatë klasa.

Klasat efaktorit paraqiten si më poshtë:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. deri në 1300 cm³	0.875
II. nga 1301 deri në 1600 cm³	0.949
III. nga 1601 deri në 1800 cm³	0.998
IV. nga 1801 cm³ deri në 2000 cm³	1.049
V. nga 2001 cm³ deri në 2500 cm³	1.091
VI. nga 2501 cm³ deri në 3000 cm³	1.142
VII. mbi 3000 cm³	1.183

- Automjetet elektrike shoqëria Ansig sh.a. do të klasifikojë deri 1300 cm³.

- m_i përfaqëson faktorin e riskut mosha e të siguruarit. Indeksi i ndahet në 2 klasa si vijon:
- eksperiencia në drejtim të mjetit motorik. Për të siguruarit të ndryshëm nga 18 deri në 21 vjeç, indeksi e ndahet në dy klasa, ku shoqëria Ansig ka mbajtur vlerën minimale të rregullores si vijon:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. 18 deri në 21 vjeç	1.141
II. Te tjere	1

- n_e përfaqëson faktorin e riskut eksperiencia në drejtim të mjetit motorik. Për të siguruarit të ndryshëm nga 18 deri në 21 vjeç, indeksi e ndahet në dy klasa, ku shoqëria Ansig ka mbajtur vlerën minimale të rregullores si vijon:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. Deri në dy vite	1

II. Mbi dy vite

1

- P_s , përfaqëson faktorin e riskut Përdorimi i mjetit: subjekt, individ. Indeksi ndahet në dy klasa, ku shoqëria Ansig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. Individ	1
II. Subjekt	1.104

Për subjektet bazuar në rregullore do të zbatohen faktorët: përdorimi i mjetit, fuqia motorike, qarku i regjistrimit të mjetit, si dhe vjetërsia e mjetit, por nuk do të zbatohet faktori moshë.

- Q_p , përfaqëson faktorin e riskut Qarku i regjistrimit të mjetit. Indeksi ndahet në dy klasa, ku shoqëria Ansig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. Berat, Dibër, Kukës	0.9698
II. Të tjera	1

V_m , përfaqëson faktorin e riskut Vjetërsia e mjetit. Indeksi ndahet në katër klasa ku shoqëria Ansig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

Klasa	Vlerat e koeficientëve
I. deri në 5 vjet	0.973
II. nga 6 deri në 10 vjet	0.999
III. nga 11 deri në 15 vjet	1.019
IV. mbi 15 vjet	1.044